

Në Egjipt në gjykimin e 269 të pandehurve duke përfshirë edhe aktivistin Ahmed Duma ndaj 230 personave jepet dënim me burg përjetë, ndërsa për 39 persona të cilët janë nën moshën 18 vjeç u dënuan me nga 10 vjet burg, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas informacioneve të marrë nga burimet gjyqësore mësohet se Gjykata Penale e Kajros në rastin e gjyimit të njohur si "Ngjarjet e ndërtesës së kryeministrit" ndaj të arrestuarit Duma dhe 229 personave të tjerë në mungesë u dha vendimi për burgim të përjetshëm. Ndërsa 39 persona të cilët janë nën moshën 18 vjeç u dënuan me nga 10 vjet burg. Gjithashtu të pandehurit kanë marrë dhe një masë ndëshkimi me 2.2 milionë dollarë në total.

Tar?k el-Avadi, avokati i aktivistit Duma në një deklaratë për gazetarin e AA tha se ky i fundit pas njoftimit të vendimit pasi "duartrokiti gjyqtarin" në shenjë proteste, mori një dënim shtesë me 3 vjet burg me arsyen për ofendim ndaj trupit gjykues.

Osama Mehdi nga ekipi mbrojtës ka theksuar se pas përgatitjes së vendimit të arsyetuar do ta apelojnë atë. Duma edhe në seancën e mëparshme po të të njëjtës çështje e cila u mbajt më 9 dhjetor mori dënim me 3 vjet burg dhe gjobë 10 mijë xhznesh (afërsisht 1 mijë e 428 dollarë) me arsyen për ofendim të gjykatës.

269 personat sëbashku me Duman akuzohen "për shkaktim të ngjarjeve para ndërtesës së Kryeministrit dhe zjarrvënies ndaj ndërtesës së akademisë".